




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-37600

Me datë: 11.07.2024

Në kuadër të ndërmarrjes së masave parandaluese të mbrojtjes nga zjarri në teritorin e Komunës së Suharekës, bëjmë këtë :

A P E L

Pasi që jemi në muajt e temperaturave të larta dhe thatësisë së theksuar, ekziston mundësia reale e shpërthimit të zjarreve, dhe e përhapjes së shpejtë e të pakontrolluar të zjarreve.

Paralajmerojmë qytetarët e Komunës së Suharekës që në këtë kohë të mos shkaktojnë zjarre në ambient të hapur, duke i ndezur hamulloret (sërrnishtet) në fushë dhe duke u bërë shkaktar të përhapjes së zjarreve edhe në pyje të cilat janë të kufizuara me ara të korrura.

Pronarët, shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve dhe hapsirave, si dhe çdo person i cili e vëren rrezikun e drejtpërdrejtë nga shkaktimi i zjarrit ose e vëren zjarrin, është i obliguar ta mënjanoj rrezikun, respektivisht ta fikë zjarrin. Nëse nuk mund ta bëjë këtë vetëm, është i obliguar të informoj stacionin më të afërm të zjarrëfikjes dhe shpëtimit, stacionin më të afërt policor, apo qendrën operative emergjente me numrin 112.

Çdo person që do të evidentohet si shkaktar i qëllimshëm i zjarrit do të ndëshkohet dhe do të ndërmerren masa Ligjore.

Kërkojmë nga qytetarët që gjatë kësaj kohe në çdo situate ti ikin përdorimit të flakës së hapur, pirjes së duhanit gjatë punëve fushore dhe ndezjes së mbeturinave nëpër prona private.

Nëpër të gjitha institucionet, ndërmarrjet punuese, pompat e benzinës dhe vende ku depozitohen karburante dhe mjete tjera ndezëse, të rritet gadishmëria, të kontrollohen pajisjet për mbrojtje nga zjarri si hidrantët përfikjen e zjarrit dhe aparatura përfikjen e zjarrit të jetë gjithmonë të përdorshme në ruajtjen e pasurisë dhe jetës së njerëzve.

Me zbatimin e këtyre masave nga ana e qytetarëve, do të kemi një ambient të sigurt për pronën dhe jetën e qytetarëve.

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ